



Pranuar / Dorezuar Primjenoi/Prodato Received/Delivered	12.04.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	3492/2023		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.427/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktar-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.427/2023 të datës 27.02.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 12.04.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

*Hedhet poshtë si e palejuar* ankesa me numër A.nr.427/2023 e datës 27.02.2023, e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Nëpunësi civil i punësuar në pozitën e punës Inspektor i Tregut në Komunën e Mitrovicës së Jugut, më datë 27.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me numër reference 01-120/08-0012404-2/2023 të datës 21.02.2023 të Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut, lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për shtesat mbi pagën bazë për kushtet specifike të punës, me pretendimin së përgjigja është dhënë më shkeljeve të dispozitave materiale dhe procedurale si dhe diskriminimit në të drejtën e rimbursimit në formë retroaktive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ( *tutje referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 07.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të organi i punësimit Komuna e



Mitrovicës së Jugut, ndërsa, kjo e fundit më datë 15.03.2023 ka përcjell shkresat lidhur me këtë çështje ankimore.

**Kolegji i Këshillit ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 2134/2023 të datës 27.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë me numër 01-120/08-0013404-2/23 të datës 21.02.2023 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit; Ndryshim dhe Plotësimin e Akt emërimit nën shenjë A.E.Nr.01-112/01-0106424/22 të datës 30.11.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 2418/2023 të datës 07.03.2023; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 266/2023 të datës 15.03.2023; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 05.08.2019; Listën e pagave për muajin Shkurt -2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e palejuar, sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, përkatësisht i njëjti sipas Aktit të Emërimit AE.Nr.01-112/01-016424/22 të datës 30.11.2022 ushtron pozitën e punës *Inspektor i Tregut* në Sektorin e Transportit Rrugor.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton së ankuesi me datë 15.02.2023 ka parashtruar kërkesë të Njësia e Burimeve Njerëzore e organit të punësimit për miratimin e shtesës mbi pagën bazë për kushte specifike të punës. Kurse, Njësia e Njësia e Burimeve Njerëzore përmes shkresës me numër 01-120/08-0012404-2/2023 të datës 21.02.2023, ka refuzuar kërkesën e ankuesit me arsyetimin së Komuna e Mitrovicës së Jugut nga miratimi i Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime tjera të Nëpunësve Civilë, nuk ka parashtruar ndonjëherë kërkesë në ministrinë përgjegjëse lidhur me miratimin e kushteve specifike të punës, andaj, në mungesë të një akti nënligjor të miratuar nga ministria përgjegjëse sipas kërkesës së institucionit, komuna nuk ka realizuar për asnjë nëpunës civil shtesë mbi pagë bazë për kushte specifike të punës.

Ankuesi në ankesën e parashtruara në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pretendon se e drejta në shtesa mbi pagën bazë për shkak të kushteve specifike buron nga dispozitat e Ligjit Nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit analizoi bazën ligjore mbi të cilën bazohen pretendimet ankimore të ankuesit, përkatësisht dispozitat e Ligjit Nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, (në fuqi nga data 25.05.2013), rrjedhimisht Kolegji mori parasysh dispozitat e nenit 10.A me të cilin është përcaktuar se: "1. Inspektorëve të tregut i njihet e drejta e marrjes së pagesës shtesë mbi pagën bazë, për shkak të kushteve specifike në punë dhe punës jashtë orarit të punës. 2. Shtesat sipas paragrafit 1. të këtij neni do të bëhet konform Ligjit përkatës për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjit përkatës për pagat e nëpunësve civil.". Në këtë kuptim, Kolegji i'u referua Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (i aplikueshëm nga data 05.02.2023) sipas të cilit me nenin 45 paragrafi 2 është paraparë se: "2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji", andaj, mbi bazën e këtij përcaktimi ligjor Kolegji konstaton së me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik është shfuqizuar çdo dispozitë ligjore që rregullon çështjen e pagave, shtesave dhe kompensimeve tjera të



nëpunësve civilë përfshirë edhe nenin 10 A të Ligjit 04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, dhe si rrjedhojë pagesat për kushte specifike të punës mund të realizohen vetëm në pajtim me kushtet dhe procedurën e përcaktuar më dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i cili zbatohet për të gjitha të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit.

Për me tepër, me nenin 22 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik si shtesa përtej pagës bazë për të punësuarit në sektorin publik janë përcaktuar: 1.1. shtesa e veçantë për të zgjedhurat/it; 1.2. shtesa për kushte tregu të punës; 1.3. shtesa e performancës; 1.4. shtesa për kushte specifike të punës; 1.5. shtesa për punën pa orar të paracaktuar; 1.6. shtesa për vëllimin e punës; 1.7. shtesa për licencë të avancuar për nëpunësen/in e arsimit para universitar; 1.8. shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor; 1.9. shtesa e performancës për krijuesen/in dhe performuesen/in e artit dhe kulturës; 1.10. shtesa funksionale. Kurse me nenin 26 të të njëjtit ligj theksohet se: Shtesa për kushte specifike të punës përfitohet nga zyrtaret/ët publik dhe të punësuarat/it e tjerë që janë të ekspozuar ndaj rrezikshmërisë në vendin e punës ose kanë kushte specifike të punës që ua rrezikojnë jetën dhe/apo shëndetin. 2. Shtesa e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni, nuk mund të jetë më e lartë se 1% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore, për pagën bazë të zyrtareve/ëve publik të organizatës buxhetore në të njëjtin vit financiar. 3. Për qëllim të zbatimit të këtij neni, Qeveria e Republikës së Kosovës do të trajtohet si një (1) organizatë buxhetore. 4. Me rastin e krijimit të funksioneve, pozitave, apo emërtesat e reja sipas nenit 42 të këtij ligji, institucioni në të cilin krijohet pozita, kur e vlerëson se kësaj pozite duhet ti takoj shtesa për kushte specifike të punës, kërkon nga ministria përgjegjëse për administratën publike dhe ministria përgjegjëse e financave pëlqimin për përfitim të kësaj shtese. 5. Pozitat përkatëse për të cilat përfitohet shtesa për kushte specifike të punës, vlera dhe procedura për përfitimin e saj miratohen me akt nënligjor nga Qeveria pas propozimit nga ministria përgjegjëse për financa.

Në zbatim të nenit 26 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Qeveria e Kosovës më datë 06.02.2023 ka nxjerrë Rregulloren (QRK) Nr.08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, e cila ka përcaktuar kriteret, kushtet, rregullat, mënyrën e llogaritjes dhe procedurën për përfitimin e shtesave të kushteve specifike të punës, rrjedhimisht me nenin 7 të kësaj rregullore parashihet se: 1. Secili institucion që vlerëson se ka zyrtarë publikë dhe të punësuar të tjerë që plotësojnë kriteret për të përfituar këtë shtesë dorëzon kërkesën për miratim të shtesës për pozitat përkatëse tek Komisioni sipas paragrafit 2 të këtij neni, me të dhënat si në vijim: 1.1. pozitën dhe numrin e të punësuarve në këtë pozitë; 1.2. përshkrimin e punës të të punësuarit; 1.3. arsyetimin e detajuar për përfitimin e shtesës; 1.4. klasën dhe koeficientin. 2. Kërkesa sipas paragrafit 1, dorëzohet tek Komisioni i cili themelohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me mandat tre (3) vjeçar, në këtë përbërje: 2.1. përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit; 2.2. përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për financa; 2.3. përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Administratë Publike.... 5. Komisioni është përgjegjës të përpiloj raport përfundimtar në bazë të kërkesave të institucioneve sipas paragrafit 1 të këtij neni, i cili duhet të përmbaj: 4.1. lista me pozitat për të cilat kërkohet shtesa e kushteve specifike të punës, të cilat i plotësojnë kushtet e përcaktuara në ligjin përkatës për pagat dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje; 4.2. vlerën indikative të rekomanduar për secilën kategori potencialisht përfituese të shtesës për kushte specifike të punës, duke respektuar kufizimet buxhetore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi; 4.3. shkaqet për mos përfshirjen e kërkesave të tjera të pranuar në përfitimin e shtesës; dhe 4.4. informatat tjera që konsiderohen relevante nga Komisioni. 5. Me nxjerrjen e raportit përfundimtar, Komisioni dërgon të njëjtin për miratim në Qeverinë e Republikës së Kosovës. 6. Qeveria, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria përgjegjëse për Financa, miraton të gjeturat e Komisionit përmes vendimit qeveritar. 7. Komisioni, në çdo kohë dhe në bazë të kërkesës së institucioneve, mund të rishikojë listën e aprovur në Qeveri dhe të propozojë ndryshimin e saj.





Bazuar në kuadrin ligjor si më sipër, dhe duke qenë së ende nuk janë finalizuar të gjitha hapat ligjor të përcaktuar më nenin 7 të Rregullores QRK) Nr.08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, gjegjësisht meqenëse Qeveria e Kosovës ende nuk ka nxjerr vendim lidhur me miratimin e pozitave që plotësojnë kriteret për pagesë për kushte specifike, bazuar në raportin dhe rekomandimet e komisionit kompetent, Kolegji vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për vendosje meritore lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, andaj, si rrjedhojë ankesa e ankuesit është e palejueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

#### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.427/2023

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

#### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

